



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

**“PËR PËRCAKTIMIN E KONTROLLUESVE TË CILËT
KANË DETYRIMIN PËR TË NJOFTUAR
KOMISIONERIN PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE
PËRSONALE PËR TË CILAT JANË PËRGJEGJËS”**

U D H Ë Z U E S

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Adresa: “Rr. Kavajës, Nd. 80, H. 1, Kati 5, 1023, Tiranë

Telefon: +35542237200

E-mail: info@idp.al

Website: www.idp.al

Tiranë 2016

Qëllimi i Udhëzuesit

Ky Udhëzues ka si qëllim të përcaktoj kontrolluesit të cilët kanë detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat janë përgjegjës, për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit.

Në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale termat Kontrollues, Përpunues dhe Palë e tretë kanë të njëjtin kuptimin si ai i përcaktuar në nenin 3 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar.

- a. "Kontrollues" është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.
- b. "Përpunues" është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që përpunon të dhëna personale në emër të kontrolluesit.
- c. "Palë e tretë" është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër, përveç subjektit të të dhënave, kontrolluesit, përpunuesit dhe personave, të cilët, nën autoritetin e drejtpërdrejtë të kontrolluesit apo përpunuesit, janë të autorizuar të përpunojnë të dhëna.

Procesi i Njoftimit

Njoftimi nga subjektet kontrollues është një detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar.

Njoftimi, është një proces me anën e të cilit kontrolluesit e të dhënave personale njoftojnë Zyrën e Komisionerit në lidhje me të dhënat që ata përpunojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Ky informacion i dhënë nga kontrolluesit, i parashtruar gjatë plotësimit të rubrikave të "Formularit të Njoftimit", pasqyrohet nga Zyra e Komisionerit në Regjistrin Elektronik të Kontrolluesve i hapur për publikun në faqen zyrtare www.idp.al.

Janë dy mënyra për të realizuar njoftimin pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale:

- ✓ Mënyra "*online*" – formulari plotësohet elektronikisht prej kontrolluesit në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit (www.idp.al), duke plotësuar çdo rubrikë të tij sipas pyetjeve të parashtruara.
- ✓ Mënyra "*manuale*" - nëpërmjet printimit të formularit të njoftimit, plotësimit të rubrikave përkatëse dhe dërgimin e tij pranë Zyrës së Komisionerit nëpërmjet postës, ose dorazi.

Kontrolluesit që kanë detyrimin për të njoftuar

Kontrollues që ka detyrimin për të njoftuar Komisionerin është subjekti publik ose privat i cili përcakton qëllimin të lidhur me mënyrën e përpunimit të të dhënave personale.

1- Kontrollues në sektorin publik, të cilët përcaktojnë qëllimin të lidhur me mënyrën e përpunimit dhe kanë detyrimin për të njoftuar për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, janë institucionet e parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr. 90/2012, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore” etj, si për shembull:

- a) Institucioni Presidentit;
- b) Parlamenti;
- c) Këshilli i Ministrave;
- d) Institucionet Kushtetuese e të Pavarura dhe të tjera, të ngritura me ligj të veçantë;
- e) Prefekturat;
- f) Institucionet shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave dhe që dhe kanë personalitet juridik publik;
- g) Ministrinë dhe institucionet e varësisë;
- h) Drejtoritë e përgjithshme;
- a) Degët territoriale të cilat janë struktura administrative të një ministrie ose një institucioni të varësisë, që krijohen për të ushtruar në territorin e një ose më shumë njësive të qeverisjes vendore, detyra administrative që mund të kryhen më mirë në territor;
- b) Njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve;
- c) Agjencitë autonome;
- d) Institucionet e arsimit të lartë publik;
- e) Përfaqësitë diplomatike jashtë vendit;
- f) Forcat e Armatosura;
- g) Bashkitë;

- h) Shoqëritë tregtare, me kapital shtetëror ose privat të cilëve u është deleguar kryerja e veprimeve administrative/ofrimi i shërbimeve publike.



Subjektet në sektorin publik të cilët në veprimtarinë e punës nuk kanë autonomi në përcaktimin e qëllimit të përpunimit të lidhur me mënyrën e përpunimit por zbatojnë vendimet e organeve drejtuese të tyre, nuk kanë detyrim për të njoftuar. Këto subjekte në kuptim të ligjit janë përpunues.

Shembull:

Degët Rajonale të Doganave përsa kohë që ato zbatojnë urdhrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave e cila ka paracaktuar dhe mënyrat e përpunimit, nëpërmjet përdorimit të sistemeve elektronike të krijuara dhe administruara nga DPD. Në këtë rast Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është në rolin e kontrolluesit ndërsa Drejtoritë Rajonale janë në rolin e përpunuesit.

2- Kontrollues në sektorin privat janë personat fizik ose juridik, fitimprurëse ose jofitimprurëse, të cilët mbledhin dhe administrojnë të dhënat personale duke përcaktuar qëllimin të lidhur me mënyrën e përpunimit dhe kanë detyrimin për të njoftuar Komisionerin, për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit.

Kontrollues në sektorin privat që kanë detyrimin për të njoftuar për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, janë edhe subjektet fitimprurës ose jofitimprurës që përcaktojnë qëllimin të lidhur me mënyrën e përpunimit, të cilët nuk janë të vendosur në Republikën e Shqipërisë, por që e ushtrojnë veprimtarinë nëpërmjet përdorimit të çdo mjeti, që ndodhet në Republikën e Shqipërisë.



Subjektet private të krijuara si degë të kontrolluesve të mëdhenj, të cilat në asnjë moment të veprimtarisë së tyre nuk përcaktojnë qëllimin të lidhur me mënyrën e përpunimit, por vetëm zbatojnë detyrimet e përcaktuara nga shoqëria mëmë, nuk janë kontrollues të të dhënave personale dhe nuk kanë detyrimin për të njoftuar Komisionerin.

Shembull:

Bankat e nivelit të dytë të cilat funksionojnë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, detyrimin për të njoftuar e ka vetëm njëësia qendrore e bankës, degët e tyre janë krijuar me qëllim krijimin e kushteve dhe lehtësirave të ofrimit të shërbimit por, këto degë nuk përcaktojnë qëllimin e përpunimit të lidhur me mënyrat e përpunimit të të dhënave pasi ato janë të përcaktuara nga njëësia qendrore e cila është i vetmi subjekt i licencuar dhe përgjegjes për kryerjen e aktivitetit bankar.

Kontrolluesit, të cilët përjashtohen nga detyrimi për të njoftuar Komisionerin mbi përpunimin e të dhënave personale, kanë detyrimin të bëjnë të disponueshme, të paktën, të dhënat për emrin dhe adresën, kategoritë e të dhënave personale të përpunuara, qëllimet e përpunimeve, kategoritë e marrësve.

Kontrolluesit, të cilët përjashtohen nga detyrimi për të njoftuar Komisionerin mbi përpunimin e të dhënave personale, nëse do të kryejnë transferim ndërkombëtar të të dhënave, kanë detyrimin për të njoftuar Komisionerin.

Mënyrat e njoftimit janë të njëjta me ato të cituara më sipër (Procesi i Njoftimit), duke plotësuar formularin e njoftimit vetëm në rubrikat ku deklarohet informacioni i kërkuar.

Ky Udhëzues përmban një shpjegim të përgjithshëm për çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër, në lidhje me detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat janë përgjegjës, për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit.

Duhet theksuar se, vlerësimi i kontrolluesve të cilët kanë detyrimin për të njoftuar do të jetë gjithmonë sipas rastit konkret dhe i bazuar në specifikat e çdo lloj përpunimi të të dhënave personale.

